

V E N D I M
Nr.228, datë 21.8.2001

PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjet e tij datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Socialdemokrate, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

Baza Ligjore: Neni 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Socialdemokrate, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumëmemërore të kësaj partie. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.784, datë 2.6.2001 "Për rregjistrimin e listës shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate, për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001".

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë, të cilët i përkasin një partie apo koalicionit të partive, në bazë të përqindjes që Partia Socialdemokrate ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 4 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumëmemërore, të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 4.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I:

1.Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Socialdemokrate, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, si vijon:

- 1.z.Skënder Gjinushi
- 2.z.Paskal Milo
- 3.z.Gaqo Apostoli
- 4.z.Engjëll Bejtaj

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gaspër Kokaj	Ilirjan Celibashi